

## STATUT

### I

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "S.I.B.A" sh.p.k.

#### Neni 1

Formohet Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "S.I.B.A" sh.p.k e ortakut të vetëm themelues Z. Shkelqim Xhemil Shehu, i datelindjes 29.7.1960, Lindur dhe banues në Tiranë në këtë adresë: Rr. Bajram Curri, Pall. 29, shk. 2, ap. I, me profesionin inxhinjer ndertimi, nr. 1 pasaportes: 285729.

#### Neni 2

Vendqëndrimi legal i shoqërisë do të jetë adresa e shtëpisë së Z. Shkelqim Shehu.

Shoqëria mund të hapë edhe vendqëndrime të dyta, operative, filjale, perfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, me miratimin e organeve përkatëse dhe sipas Legjislacionit të vendit ku ato hapen.

#### Neni 3

Veprimtaria ekonomike e shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet

#### Neni 4

Objekti i aktivitetit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "S.I.B.A." sh.p.k. do të jetë:

- Tregtim i artikuljeve të ndryshme industriale, ushqimore, konfeksione, me shumicë e pakice, import eksport.
- Transport mallra e udhëtarë, turizëm, brenda e jashtë vendit.
- Veprime komisionerie, kambizmi, agjitje linjash e impjantesh, eksport import produkte bujqësore, blektorale, bime medicinale, përpunim i tyre.
- Shitje e blerje pasurish të tundshme e të patundshme.
- Prodhim të ndryshme industriale etj. në fabrike etj.
- Marrje e dhënie kredie me çfarëdo lloji kushti dhe për llogari të cilitdo të tretit operacione burse, këmbio në odo treg financiar e botëror.
- Hapje kurse për shoferë.
- Punime dheu, murature betoni, b. arme të zakonshme, punime shembje, ndertime civile, industriale, turistike, bujqësore etj. kompletimi me instalimet e nevojshme për to, punime reataurimi, vepra b. arme të vecanta,
- prodhim tregtim i materialeve të ndertimit të lendeve të para, me shumicë e pakice import eksport.

#### Neni 5

Shoqëria mund të ndryshojë emërtimin, vendqëndrimin sid dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrin Presidenti i saj.

#### Neni 6

Kapitali themelor i shoqërisë do të jetë 100.000 leke dhe është kontribut i vetëm i Z. Shkelqim Shehu.

#### Neni 7

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimeve që

do te marre Presidenti i saj.

#### Neni 8

Organet drejtuesete shoqerise ne pergjegjesi te kufizuar "S.I.B.A."sh.p.k. jane:

-Presidenti

-Administratoret

-Komisioni i Revizionimit

Presidenti ka ato funksione qe do te kryente asambleja. Ai eshte organ sovran i shoqerise. Ai qeveris veprimtarine duke u mbeshtetur ne te drejten e tij mbi pronesine mbi sjetet e investuara ne shoqeri. Presidenti emeron administratoret dhe komisionin e revizionimit si dhe percakton detyrat dhe te drejttat e organeve

Vendimet qe merr presidenti jane te detyrueshme per te gjitha. Presidenti zhvillon mbledhje te zakonshme e te jashtezakonshme. Presidenti eshte i veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem e te jashtezakonshem pa asnjë lloj kufizim apo perjashtim. Ai ka mundesi te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme per realizimin e celimeve te shoqerise.

#### Neni 9

Shoqeria private deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban statuti i saj si dhe ato te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me rregjistrimin e saj ne Gjykaten e Rrethit Tirane si person juridik ndersa ushtron aktivitetin ekonomik me rregjistrimin e saj ne organin tatimor te <sup>A</sup>ajonit nr. I Tirane.

#### Neni 10

Shqeria do te kete vullen e saj.

#### Neni 11

Shoqeria vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejttat e detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore e jashte kontraktore brenda kapitalit te saj. Themeluesi mbart rezikun e veprimtarise se Shoqerise deri ne nivelin e shumes se investuar.

#### Neni 12

Presidenti i shoqerise emeron administratore te cileve ne aktin e emerimit te tyre ju percakton detyrat e pagen po keshtu edhe per punetoret e punesuar ne shoqeri. Ai merr persiper te respektoj rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise per punesimin dhe sigurimet shqra shoqerore per te punesuarit. Te gjitha te punesuarit jane te detyruar te pranojne kete statut.

#### Neni 13

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes abatohet dispozitat e punes se legjislacionit shqiptar ne fuqi.

#### Neni 14

Te punesuarit ne firm shoqeri pergjigjen sipas statuiti per moszbatimin e

e detyrave dhe pr per demet qe i shkaktojne shoqerise.

Neni 15

Punonjesit nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit qe realizon shoqeria gjate ushtrimit te veprimtarise se saj ne se ne kontrata e punes nuk parashikohet ndrysh ndryshe.

Neni 16

Administratori nuk mund te marre cilesine e ora kut ne shoqeri dhe te ush-troje nje aktivitet konkurrues te cfaredo lloji per llogari te xi tyre ose te treteve pervec atyre te autorizuar nga presidenti .Per odo shkelje ne kete drejtim administratori largohet nga puna dhe pergjigjet per demet e shkaktuara.

Neni 17

Te gjitha te punesuarit ne shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes. Sekret pune paraqesin shkruesat, materilet e aktet te cilat me ligj dhe me dispozitat e vecanta sidhe vendimet e nxjerra nga themeluesi i shoqerise jane shpallur sekret pune. Teshenat informative, bilancet, plane dhe informacionet per politiken ekonomike te shoqerise qe u jepen organeve te miratuara firmosen nga presidenti i shoqerise.

Neni 18

Detyra mbi ruajtjen e sekretit te punes nga te punesuarit ne firme vashdon dhe pas largimit te tyre nga kjo firme.

Neni 19

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise mbyllen ne 31 dhjetor te odo viti. pervec rasteve dhe urdhrave te vecanta te presidentit te shoqerise. Ne fund te odo perudhe ushtrimore administratoret nxjerrin bilancin kontabel te shoqerise me rezultatin ekonomik Fitim-Humbje, bazuar ne ligje e rregulla te mbajtjes se kontabilitetit nga njesite ekonomike private percaktuar prej organeve kopetente te sistemit fiskal. Ne miratimi e bilancit kontabel vjetor shoqeria vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme s

Neni 20

Shperberja e shoqerise mund te vije ne odo kohe dhe per cfaredo shkak.

Neni 21

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kopetente dhe nje kopje mbetet ne ruajtje te dokumentacioneve te shoqerise. Statuti hyn ne fuqi dite e nxjerrjes se tij nga ~~artikulli~~ presidenti i shoqerise Z. Shkelqim Shehu.

Presidenti

(Shkelqim Shehu )

Tirane ne 08.04.1993

